REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 289119
Datë/Datum. 07.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

A N K E S Ë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Komuna e Podujevës, *adresa:Rr,Zahir Pajaziti, Podujeve*

Për ; *Aktivitetin e Prokurimit: NR i prokurimit '615-19-942-521, numri i brendshëm: 61519011521*

Sa i përket tenderit për: Ndërtimi i serave për fermer

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK

Konzerciumi "PMC " SH.P.K & NTP "ADRIZAUN-RRETHOJA"
(Emri i OE)
Rr.Ulpianë,Isa Boletini P+8/1 & Qifllak, Rahovec,
(Adresa e OE)
Prishtine & Rahovec
(Selia)
mail: pmc.pristina@gmail.com & adrizaun-rrethoja@hotmail.com
(Adresa elektronike)

Bedri Sylejmani *(PMC)*
(Drejtori)

Ardian Thaqi *(Adrizaun-Rrethoja)*
(Drejtori)

SHOQËRIA E PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR PMC SH.P.K. PRISHTINË

N.T.P. "Adri Zaun - Rrethoja" 70517604 Rahovec-Qifllak

Me date: 07.06.2019

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Komuna e Podujevës, me date 08.03.2019, ka publikuar ne Ueb faqen e KRPP-se, Njoftimin për kontrate per aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; " **Ndërtimi i serave për fermer**"
Tenderi është udhëhequr me:

- Numër të prokurimit' *615-19-942-521,dhe* numri i brendshëm: *61519011521,*
- Procedure e hapur,
- Kontrate publike kornizë me një operator ekonomik
- Pune, Vlerë e madhe.
- Vlera parashikuar e kontratës 162.396,32 euro
- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qen me datë është 02.04.2019, në 13:00 nëpërmjet E- prokurimit.

Vendi i hapjes dhe koha e hapjes se ofertave ka qen e përcaktuar ne ora 13:00 vendi zyra nr .48, Podujeve.

Me date 24.05.2019 kemi pranuar Njoftimin per Letër standarde për tenderuesit e pasuksesshëm nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.

Me date 27.05.2019 kemi kërkuar qasje ne dokumentet publike të tenderit.

Me date 28.05.2019 kemi realizuar te drejtën për qasje në dokumentet publike në Zyrën e prokurimit të K. K. Podujevës.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

Me date 24.05.2019 kemi pranuar Njoftimin per Letër standarde për tenderuesit e pasuksesshëm nga dhe Njoftim mbi vendimin AK.

Të pakënaqur me Vendimin për Dhënies te kontratës dhe Vendimin per tenderuesin e pasuksesshëm dhe ne pajtim me nenin 10 te LPP-se me datë 27.05.2019 kemi kërkuar qasje ne dokumentet publike të tenderit.

Me datë 28.05.2019 kemi marre qasjen ne dokumentet e tenderit konforme kërkesës.

Gjate procedurës se qasjes kemi marre kopjen elektronike të ofertuesit te propozuar per kontrate per aktivitetin e lartpërmendur te prokurimit.

Nga kopjet e siguruara nga Zyrtari përgjegjës i prokurimit kemi konstatuar se OE NTP " Liria"i propozuar per shpërblim te kontratës me vlere totale te kontratës 119,217.00 € , është i papërgjegjshëm ne kuptim te dispozitave te LPP-se , kushteve formale - administrative te pjesëmarrjes ne tender te përcaktuara ne Njoftimin per kontrate dhe dosje të tenderit.

Si rrjedhe e kësaj me datë 29.05.2019 kemi ushtruar Kërkesë për rishqyrtim të Vendimit me pretendimin se AK; Komuna e Podujevës nëpërmes Komisionit per vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë zhvillimit të procedurës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te tenderit ka bere shkelje te dispozitave te LPP-se, Rregullave dhe UOPP dhe atë :

Nenin,51, Nenin 52, Nenin 59, Nenin 66, Nenin 67, Nenin 68, Nenin 69,
Nenit 10, te dispozitave te LPP-se,
dhe
Nenin 41 te Rregullave dhe UOPP.
Provë; Kërkesa per rishqyrtim e datës 29.05.2019

Me date 31.05.2019 kemi pranuar Vendimin për refuzimin e kërkesës me arsyetimin se; "*AK pas analizimit te pretendimeve ankimore konstatoi si te pabazuar kërkesën per rishqyrtim me arsyetimin se OE i shpallur fitues ne aktivitetin e prokurimit ne fjale është i përgjegjshëm , me çmimin ofertues me te lire si dhe i plotësoi kushtet sipas dosjes se tenderit ".*
Dokumentacioni sipas pretendimit ankimor i është bashkëngjitur ofertës brenda afatit ligjor. Kjo është bere ne kërkesë te Zyrës se Prokurimit duke zbatuar rregullat ivën nga nenet 66,68,69 te LPP-se"

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pakënaqur me: Vendimin për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim dhe Njoftimin dhe Vendimin per dhënie te kontratës te rekomanduar nga Komisioni per vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit te aprovuar nga Zyrtari

Përgjegjës i prokurimit te AK-se dhe ne pajtim me nenin 108A të LPP-se, parashtrojmë këtë ankese kundër:

- Vendimin për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim te datës 31.05.2019,

Dhe

- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues te Komunës se Podujevës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; Ndërtimi i serave per fermer , Nr. i prokurimit 615-19-94-521 dhe nr. te brendshëm 61519011521 dhe rezultatit te aktivitetin te prokurimit ku është shpërblyer me kontrate OE NTP "Liria" ne vlere totale te ofertës 119,217.00 € te datës 24.05.2019.

Pretendojmë se AK-Komuna e Podujevës përmes Komisionit per vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I-Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *(në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë) konkretisht:*.

- Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave,
- Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,
- Neni 60 , Kriteret per Dhënien e Kontratës

II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

- Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

LIGJI Nr. 05/L -037
PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Në vazhdim të kësaj ankese do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

1. **Të dispozitave të LPP-se në RK.**

- ***Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi***

Rekomandimi i Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit që, tenderi i OE; NTP " Liria"_ të shpërblehet me kontratë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender.

Pabarazia në trajtim si dhe favorizimi i një operatori si dhe diskriminimi i operatoreve tjerë është bere nga ana e AK në procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes së OE dhe me rastin e shpërblimit të kontratës. Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues qe gjate zhvillimit te procedurës se vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit te tenderëve të i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

- **Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-se në Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji

Duke u bazuar ne Kërkesat formale administrative te pjesëmarrjes ne tender , te përcaktuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontratë si dhe ne dispozitat e nenit 56 paragrafi1.1 dhe 1.2 te LPP-se, si dhe bazuar ne dëshmitë e dorëzuara nga OE NTP " Liria" pretendojmë se AK-KK Podujeve përmes Komisionit per vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2 te LPP-se.

- ***Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate ofertën e OE NTP " Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 59 , paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2. *Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.*

4. *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii)*

përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Duke u bazuar në Kërkesat formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në paragrafin 8.1 & 8.2 - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare si dhe ne paragrafin 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te Njoftimit për kontrate dhe në Dosjen e tenderit si dhe bazuar në dispozitën e nenit 59 paragrafi 2 dhe 4 të LPP-së si dhe ne dëshmitë e dokumentuara të OE të propozuar për kontrate NTP " Liria " shohim se AK; KK Podujevë ka bere vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Në vijim te kësaj ankese do të përpiqemi që të i argumentojmë pretendimet ankimore ;

1. AK në Njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit në paragrafin; 8.1& 8.2 ka kërkuar:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar:** **OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00euro.**	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:*** **Sipas nenit 68 pika 1.5, deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës**

Duke u bazuar në dëshmitë e pranuara në kopje me rastin e qasjes në dokumentet e publike të fituesit të propozuar për kontratë NTP " Liria " dëshmi të dokumentuar, ka ofruar nga ATK-ja ; Dëshmi mbi Gjendjen e përgjithshme te deklarimeve dhe transaksioneve tjera për vitin 2012 deri me 2018 si dhe Formularët e Deklarimit në TVSH për vitin 2018, ndërkaq AK ka kërkuar nga OE që për tu kualifikuar OE duhet të plotësojnë; *Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht te dëshmoj se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 320,000.00euro,* duke e dëshmuar me ***Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.***

Prove: Kopjet e dëshmive të OE; NTP " Iliria"

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se OE i propozuar per shpërblim të kontratës nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së përkitazi me plotësimin e kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare përkatësisht nuk ka ofruar dëshmi kon formë kërkesës së AK-se nga ATK-ja ; **Deklaratat tatimore vjetore për tri vitet e fundit** *dhe mbi ketë bazë AK gjatë procedurës së përzgjedhjes së pjesëmarrësve ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 të LPP-së.*

2. AK ne Njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit ne FDT te dosjes se tenderit ne paragrafin; 9.1 & 9.2 ka kërkuar:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Projektet e realizuara (të natyrës së ngjashme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 240,000.00euro Në rast të**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës tre vjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë**

		grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit	duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose çertifikatë ose raporte të pranimit
		OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 15 punëtorë a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit	Lista me numër të punëtoreve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata e punës Nëse inxhinieri nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrveshja për angazhim në këtë projekt
		Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt	Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër)

Duke u bazuar ne dëshmitë e pranuara ne kopje me rastin e qasjes ne dokumentet e publike te fituesit te propozuar per kontratë NTP " Liria " dëshmi te dokumentuar mbi plotësimin e kërkesës per mundësitë teknike dhe profesionale ka ofruar dëshmi nga Lista e kontratave mbi projektet e realizuara gjate periudhës tre vjeçare per furnizime me material te ndryshëm ndërtimor dhe pajisje per sera, ndërkaq AK ka kërkuar nga OE qe te ofrojnë projekte te realizuar te natyrës se ngjashme ne vlere prej 240 000 euro, qe do te thotë qe OE duhet te dëshmojnë se kane përfunduar projekte te natyrës se ngjashme per punimin përkatësisht Ndërtimin e serave per fermer.

Bazuar ne dëshmitë e OE te propozuar per kontrate ne vend te dëshmive per "**pune**" ka ofruar dëshmi per "furnizime", ne vend te kërkesës per pune te ngjashme per ndërtim te serave per fermer ka ofruar dëshmi per furnizime me material te ndryshëm ndërtimor dhe per sera.

Duke pasur parasysh faktin qe AK , konforme nenit 68 paragrafi, 1 te LPP-se ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin per kontrate ka kërkuar nga OE qe përveç qarkullimit minimal financiar ne shume prej 320,000.00 euro te plotësojnë edhe një qarkullim i caktuar si minimal ne fushën specifike (ndërtim te serave per fermer) te mbuluar me kontrata ne shume prej 240,000.00 euro. Kërkesë specifike e AK-se e
caktuar me qellim qe te përzgjedhë një operator ekonomik i cili do te plotësoj kushtet minimale per kualifikim dhe përzgjedhje.

Bazuar në dëshmitë e dokumentuara të OE NTP "Liria" pretendojmë se Oferta është e papërgjegjshme në kuptim të dispozitave të LPP-se dhe si e tillë duhet të eliminohet nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit.

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara pretendojmë se AK Komuna e Podujevës gjatë zhvillimit të procedurës vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit me rastin e përzgjedhjes se pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 dhe 4 te LPP-së.

➢ ***Neni 60 , Kriteret për Dhënien e Kontratës***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate ofertën e OE NTP " Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 60 , paragrafin 1, dhe nën paragrafin 1.1 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

LPP ne nenin 60 paragrafi1. 1.dhe nen paragrafin 1.1 përcakton:

1. *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:*

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktin që AK;KK- Podujevë e ka trajtuar Ofertën e OE NTP "Liria" si të përgjegjshme edhe përkundër asaj se nuk i ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, si dhe duke pasur parasysh faktin që LPP në nenin 60 parasheh që; *Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët,* pretendojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 60 të LPP-së.

II-Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

➢ Neni 41, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të shpërblyer me kontrate ofertën e OE NTP " Liria" ka vepruar në kundërshtim me neni 41. Rregullave dhe UOPP.

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik ne piken 41.percakton:

41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë **menjëherë** pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se *5 dite* pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 92

41.3 **Parimet kryesore** të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë:

1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.

2. Tenderët duhet ët jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).

3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.

4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.

5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.

6. Asnjë negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 te LPP.

7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre te lejuara me nenin 59 dhe 72 te LPP-se.

8. Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.

41.5 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:
a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;

c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

41.6 Të qenët "**në pajtueshmëri**" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

Duke u bazuar në Raportin e vlerësimit te tenderit shohim se AK' KK Podujeve ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e pikës 41 të Rregullave dhe UOPP.

- Tenderi është vlerësuar përtej afateve të përcaktuara 30 + 20 ditë kalendarike,
- Nuk janë respektuar parimet kryesore të vlerësimit të tenderit,
- Vendimi për dhënie të kontratës është bere në kundërshtim me të qenit në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes (më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP-së)
- Nuk është zhvilluar procedura *Inter alies* me OE të propozuar për kontratë për të sqaruar dëshmitë lidhur me plotësimin e kërkesave për kapacitetin ekonomik-financiar (Deklaratat Vjetore Tatimore nga ATK-ja), pastaj nuk është kërkuar nga OE qe te sqaron dëshmitë lidhur me plotësimin e kërkesave mbi posedimin e kapacitetit teknik dhe profesional (Dëshmitë per kontrata dhe referenca te natyrës specifike per " Ndërtim te serave per fermer)" ne vlere totale te kontratave te përfunduara ne shumen e kërkuar nga AK: 240,000.00 euro, (më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP-së)

- Nuk janë kualifikuar drejte termat e referencës per "Pune te kontraktuara per projekte te ngjashme, (më gjerësisht shih pretendimet për shkeljet e pretenduara të nenit 59 të LPP-së)

Duke u bazuar në faktet e lartshënuara pretendojmë se AK; Komuna e Podujevës gjatë zhvillimit të procedurës vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit me rastin e përzgjedhjes se pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës ka vepruar në kundërshtim me piken 41 te rregullave dhe UOPP.

PËRFUNDIM

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga OSHP-se që:

- *Të aprovoj ankesën si të bazuar,*
- *Te anuloj Vendimin e AK-se KK- Podujeve te datës 24.05.2019 mbi dhënien e kontratës per OE NTP "Liria " per tenderin" Ndërtimi i serave per fermer" ne vlere prej* 119,217.00 €
- *Te kthej tenderin ne **RIVLERESIM**,*
- *Te vlerësoj tenderin ne pajtim me kërkesat e përcaktuara ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosje te tenderit.*

VËMENDJE: Në mënyrën më të sinqert të mundëshme, ne grupi i operatorve ekonomik "PMC" & "ADRI ZAUN-RRETHOJA" nuk po kërkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit-OSHP në asnjë mënyrë

të na favorizoj neve si konzorcium, por vetëm po kërkojm të vlerësohen me kujdes shkeljet e bëra nga Komuna e Podujevës të kritereve të cilat vetë ajo i ka përcaktuara në dosje të tenderit e ku në të njëjtën kohë ajo vetë i shkelë këto kritere. Vetë grupimi ynë në formë konzorciumi tregon se sa seriozishtë e kemi marr plotësimin e kritereve të përcaktuara nga Komuna e Podujevës, në mënyrë që oferta jonë të jetë e përgjegjshme. Ndërsa Komuna e Podujevës duke mos respektuar kriteret të cilat vetë i përcakton, përzgjedhë OE NTP " Liria " fitues të kësaj kontrate që nuk ka të bëjë asgjë me ndërtim të serave. Me një vështrim të thjesht të dokumentacionit të NTP "Liria" mundë shihet qart se operatori në fjal nuk ka të bëjë asgjë me natyrën e punëve të cilat duhet të kryhen në kuadër të kontratës dhe aktivitetet të cilat kryen ky operator nuk kan kurfar relevance me punën që duhet të bëhet me kontratë
Prandaj ANKESA jonë nuk po bëhet sa për të bërë një akt formal juridik, por mendojm se duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik të Republikës së Kosovës jemi të bindur se me të vërtet jemi në anën e drejt, në këtë rast.

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet DREJT.

Faleminderit,

Me nderime,

Konzerciumi

Bedri Sylejmani
Drejtori " PMC " SH.P.K

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PMC SH.P.K. PRISHTINË

Ardian Thaqi
Drejtor NTP "ADRIZAUN-RRETHOJA"

N.T.P. "Adri Zaun Rrethoja" Rahovec-Qirilak

Prishtinë

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani nuk kemi pasur dëme materiale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues"*
c) *një kopje të letrës së tenderuesit te pasuksesshëm,*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
e) *një kopje te Kërkesës per rishqyrtim*
f) *një kopje te Vendimit per refuzimin e kërkesës,*
g) *një kopje te Kërkesës per qasje ne dokumentet publike*